



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1052/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit, Frigo Limi shpk me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rashiti avokat,, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit-paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.218/2024 të datës 22.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.05.2024, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e propozuesit-paditësit, Frigo Limi shpk me seli në Gjilan, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.218/2024 i datës 22.04.2024, Vërtetohet

### A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.218/2024 të datës 22.04.2024, është Refuzuar Kërkesa e paditësit-propozuesit Frigo Limi shpk me seli në Gjilan, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar-vendimit nr.protok.75/2024 datës 18.03.2024 të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit - propozuesit, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të LKA-së, dhe procedurës kontestimore, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet si e

bazuar ankesa e propozuesit Frigo Limi shpk nga Gjilani, të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.218/2024 i datës 22.04.2024 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje lidhur me propozimin për shtyrje të ekzekutimit të vendimit nr.75/2024 dt.18.03.2020 si dhe Raport kontrolli i dt.24.01.2024 i ATK-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Dhoma e shkallës së dytë, duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së propozuesit-paditësit, gjen se dhoma e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit, për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të paditurit nr.protok.75/2024 datës 18.03.2024, ka refuzuar propozimin e paditësit për shtyrje te ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar, me arsyetimin se paditësi nuk ka dëshmuar se është përmbush kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i pariparueshëm, se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit apo humbjeve tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues. Nga propozimi për shtyrje te ekzekutimit të vendimit të paditurës dhe shkresave tjera, gjykata nuk ka gjetur asnjë provë të vetme me të cilën do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ në këtë rast. Propozuesi ka bashkangjitur si provë: vendimin kontestues, raportin e kontrollit, librin e shitjes, libreza e veturave, formularët e deklarimit tatimor, të cilat dokumente në asnjë rrethanë nuk dëshmojnë se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit apo humbjeve tjera. Gjykata e shkallës së parë, vendimin e referon ne nenin 22 të LKA-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të dhomës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtarë përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi, me propozimin e ushtruar, kërkon që të caktohet masa e përkohshme e sigurisë-shtyrja e ekzekutimit të vendimit të paditurit nr.protok.75/2024 datës 18.03.2024 deri në vendosjen meritore të padisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozuesit- paditësit, në ankesë, ndaj aktvendimit të Dhomës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Dhomat e shkallës së parë-Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit-propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, dhe se nuk është cënuar ligji në dëm të ankuarit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Kolegji i vlerësoi të pa mjaftueshme dokumentet e bashkangjitura në shkresat e lëndës, se me ekzekutimin e vendimit paditësit do sillte dëm të pariparueshëm. Paditësi nuk ka provuar gjykatës se obligimi tatimor i caktuar me Raport kontrolli, i konfirmuar me vendimin kontestues të paditurës Divizioni i Ankesave i ATK-së, do të shkaktonte dëm të pariparueshëm, dhe do të rrezikojë gjendja financiare-materiale në rast të mbledhjes së detyrueshme të obligimit tatimor nga e paditura. Kolegji vlerësoi se paditësi nuk ka paraqitur para dhomës së shkallës së parë dëshmi të mjaftueshme, me të cilat prova do të vërtetohej se ekzekutimi i vendimit kontestues, paditësit do të shkaktonte dëm i pariparueshëm në ushtrimin e veprimtarisë, në vështrim të nenit 22 të LKA-së. Provat e paraqitura me ankesë, Kolegji tani nuk i vlerësoi si relevante për ta ndryshuar aktvendimin e atakuar.

Sipas vlerësimit të Dhomave të shkallës së dytë, aktvendimi i atakuar i Dhomës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1052/24 datë 29.05.2024

Kryetari i Kolegjit  
Krenar Berisha